

Maksimilian Lamperc në Mirditë, 1916, dhe zbulimi i koleksionit të tij fotografik

nga
Robert Elsie

Ndër albanologët kryesorë gjermanishtfolës të shekullit të njëzetë, bashkë me austriakun Norbert Jokl (1877-1942) dhe baronin hungarez Franc Nopça (1877-1933), është pa dyshim edhe austriaku Maksimilian Lamperc (1882-1963). Një bursë qeveritare bëri të mundur që shkencëtari i ri të bënte një udhëtim në Itali dhe në Greqi, gjatë të cilit, duke përgjuar bisedimet e peshkatarëve të Atikës dhe të barinjve të Thivis, ai ra në kontakt për herë të parë me gjuhën shqipe.

1.Kush ishte Maks Lamperc?

Filologu austriak Maks Lamperc (Maximilian Lambertz) u lind më 27 korrik 1882 në Vjenë ku dhe u rrit. Ai studioi gjuhësinë krahasimtare dhe filologjinë latine dhe greke në Universitetin e Vjenës nga 1900-1905 dhe kreu doktoraturën mbi *Die griechischen Sklavennamen* (Emrat greke të skllëvërve), Vjenë 1907. Një bursë qeveritare bëri të mundur që shkencëtari i ri të bënte një udhëtim në Itali dhe në Greqi, gjatë të cilit, duke përgjuar bisedimet e peshkatarëve të Atikës dhe të barinjve të Thivis, ai ra në kontakt për herë të parë me gjuhën shqipe. Pas kthimit në Vjenë, Lamperc filloi të jepte mësim në shkollë, por pas pak kohe shkoi në Mynih për të bashkëpunuar në fjalorin e madh të gjuhës latine *Thesaurus Linguae Latinae*. Në vitin 1911, u kthye në Vjenë për të vazhduar punë si mësues në një shkollë të mesme. Botimi i tij i parë albanologjik, bashkë me Gjergj Pekmezin (1872-1938), qe një doracak dhe libër leximi i gjuhës shqipe (*Lehr- und Lesebuch des Albanischen*), Vjenë 1913. Në vitet 1913-1914, ai udhëtoi për disa javë në Italinë e Jugut për të mësuar të folmet arbëreshe. U përqëndrua kryesisht mbi të folmet më pak të njohur të Abruceve dhe të Molizes, në veçanti mbi të folmen e Badhesës (Villa Badessa).

Në maj dhe qershor të vitit 1916, Maks Lamperc udhëtoi për herë të parë në Shqipëri si anëtar i Komisionit për Ballkanin të Akademisë Austriake të Shkencave për të kryer hulumtime gjuhësore dhe folklorike. Gjatë këtij udhëtimi ai kaloi në Grudë, Shkodër, Lezhë, Krujë, Tiranë, Durrës, në luginën e Kirit, Shosh, Shalë, në luginat e Drinit dhe të Valbonës, dhe në veçanti në Mirditë ku qëndroi shumë kohë duke studiuar dialektin dhe duke mbledhur material folklorik. Në dhjetor të vitit 1916 u kthye përsëri në Shqipëri, kësaj radhe me trupat austro-hungareze të cilët kishin pushtuar zona të gjera të Shqipërisë së Veriut dhe të Mesme, dhe u ngarkuar me mbikëqyrjen e shkollave në zonën austro-hungareze. Ishte gjithashtu anëtar i Komisionit Letraro Shqipe të ngritur nga autoritetet austro-hungareze për të vendosur një normë letrare dhe një drejtshkrim standard për gjuhën shqipe. Gjatë qëndrimit të Shkodër, ai bashkëpunoi me Gjergj Fishtën në redaksinë e gazetës së përdyjavshme *Posta e Shqypnies* (1916-1918), në të cilën botoi disa artikuj. Materiali i tij folklorik u paraqit gjermanisht për herë të parë në vëllimin

Volkspoesie der Albaner: eine einführende Studie (Poezia popullore e shqiptarëve: një studim hyrës), Sarajevë 1917.

Lamberci u kthye në Austri pas Luftës së Parë Botërore dhe punoi mësues shkolle deri në vitin 1934. Gjatë asaj kohe ai vazhdoi të shkruante libra dhe artikuj për aspekte të ndryshme të kulturës shqiptare, veçanërisht të folklorit. Në moshën 53, me banim në Vjenë, në rrugën Metternichgasse 7/II/10, ai iu kthye studimeve universitare për teologjinë protestante, por disertacioni i tij u hodh poshtë nga fakulteti për arsye racore - nëna e tij kishte qenë me prejardhje hebrej. Në vitin 1939, Lamberci u kthye në Mynih për të vazhduar punë me fjalorin latin, dhe mbeti aty deri në vitin 1942. Në 1943 shkoi në Lajpcig ku dha mësim në frengjisht dhe italisht dhe ku bashkëpunoi në enciklopedinë e njohur të botës antike *Realenzyklopädie der Altertumswissenschaften* të Pauly-Wissowa-it.

Në qershor të vitit 1945, pasi u bë anëtar i partisë komuniste, u emërua drejtor i Shkollës së Lajpcigut për Gjuhë të Huaja dhe, në tetor 1946, u bë profesor i studimeve krahasimtare dhe Dekan i Fakultetit të Pedagogjisë së Universitetit Karl Marks të Lajpcigut. U bë gjithashtu drejtor i Institutit të Studimeve Indoevropiane deri në vitin 1957 kur doli në pension. Lamberci e vizitoi Shqipërinë në qershor të vitit 1954 dhe në 1957 dhe, edhe pas prishjes së marrëdhënieve të ngushta politike midis Shqipërisë dhe Paktit të Varshavës, ai refuzoi të shkëpuste lidhjet me Shqipërinë dhe mori pjesë në disa pritje të ambasadës shqiptare në Berlinin lindor.

Gjatë kohës kur punoi profesor në Lajpcig, Lamberci jetoi me gruan e tij austriake në një vilë në lagjen Markkleeberg. Martesa nuk ishte e lumtur dhe çifti nuk pati fëmijë. Aty profesori vdiq më 27 gusht 1963. U varros në varrezat Wien-Döbling në qytetin e lindjes, Vjenë.

Megjithëse Maks Lamberci nga shkollimi ishte specialist për gjuhën latine dhe greke, dhe më vonë teolog, pasioni i tij kryesor ishte dhe mbeti gjuha shqipe. Tani ai konsiderohet albanologu më i shquar gjermanishtfolës i shekullit të njëzetë i cili ka lënë një listë të gjatë botimesh me rëndësi parësore: *Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde* (Përralla shqiptare dhe tekste të tjera të folklorit shqiptar), Vjenë 1922; *Zwischen Drin und Vojusa: Märchen aus Albanien* (Midis Drinit dhe Vjosës: Përralla nga Shqipëria), Lajpcig 1922; *Albanisches Lesebuch mit Einführung in die albanische Sprache* (Libër leximi në shqip me një hyrje për gjuhën shqipe) në dy vëllime, Lajpcig 1948; *Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos "Lahuta e Malcís," Laute des Hochlandes: eine Einführung in die albanische Sagenwelt* (Gjergj Fishta dhe eposi heroik "Lahuta e Malcís," Hyrje në botën e legjendave shqiptare), Lajpcig 1949; *Die geflügelte Schwester und die Dunklen der Erde: albanische Volksmärchen* (Motrat fluturake dhe të Errëta të Tokës: përralla shqiptare), Aizenah 1952; *Lehrgang des Albanischen* (Kursi i shqipes) në tre vëllime, Berlin 1954-1955, Halle/Saale 1959; *Albanien erzählt: ein Einblick in die albanische Literatur* (Shqipëria rrëfen: hyrje në letërsinë shqiptare), Berlin 1956; dhe *Die Volksepik der Albaner* (Eposi popullor i shqiptarëve), Halle 1958. I pabotuar mbeti dorëshkrimi i tij prej 187 faqesh *Das Drama im albanischen Theater von heute* (Drama në teatrin shqiptar të sotëm), shkruar në vitin 1963.

2.Zbulimi i koleksionit fotografik të Lambercit

Në maj të vitit 2006 më kontaktoi një zotni nga Gjermania lindore që nuk e njihja. Më tha se në shtëpinë e tij ai kishte disa sende të trashëguara nga profesori Maksimilian Lamberc. Duke

qenë se ishte i moshuar dhe kishte për të shitur shtëpinë e vetë, ai donte të lirohej nga plaçkat e tepërta dhe, duke ditur se unë kisha botuar për Lambercin, më pyeti se kush mund të interesohej për këto sende. Përndryshe ai donte t'i flakte në plehra.

Kur u takuam disa javë më vonë në Bon, më shpjegoi se në fund të viteve dyzet, pas Luftës së Dytë Botërore, kur kishte qenë djalë i vogël, ai kishte jetuar në një pallat me Lambercin në qytetin e Lajpcigut. Profesori Lamerc vetë nuk kishte fëmijë, kështu që u krijuan marrëdhënie të ngushta miqësore midis profesorit plak dhe këtij djali me familjen e tij. Edhe më vonë kur Lamerci, dekan në Universitetin e Lajpcigut, kishte marrë një vilë të bukur në një lagje të mirë të qytetit, dhe djali kishte ikur me familjen në një qytet tjetër, nuk u shkëputën lidhjet.

Pas vdekjes së Lamercit në gusht të vitit 1963, gruaja austriake e profesorit, me të cilën duket se ai nuk kishte marrëdhënie të mira, u kthye në Vjenë, pa u interesuar shumë për trashëgiminë albanologjike të burrit. Rrethanat erdhën të tilla që bashkëbiseduesi im ndihmoi në zbrazjen e vilës së Lamercit dhe mori disa sende për vete, të cilat i ruajti më shumë se dyzet vjet në shtëpi. Duke qenë se ai kishte punuar kimist dhe nuk kishte shumë njohuri as për Shqipërinë dhe as për albanologjinë, ai nuk u interesua për vlerën shkencore të trashëgimisë së Lamercit. Ai i mbajti sendet më shumë si kujtim për nder të profesorit të dashur i cili kishte ndërhyrë për atë një herë kur kishte patur probleme me autoritetet komuniste të vendit.

Gjatë takimit që zhvilluam, ky zotni më solli dhe më dha sendet e mbetura të albanologut të madh, duke më falënderuar përzemërsisht për gatishmërinë time për t'i pranuar. Nga ana ime, unë e sigurova se isha tepër mirënjohës, bile i mahnitur për këtë dhuratë të çmuar. Për mua ishte vërtetë një thesar i madh.

Ndër sendet e ruajtura të Lamercit gjatë dyzet viteve ishin disa libra (botime origjinale të tij dhe disa libra latinisht), disa foto në letër të Lamercit, por në radhë të parë, një kuti e bukur prej druri. Kjo kuti përmbante një koleksion fotografish të vjetra, gjithsej 45 diapozitiva prej xhami.

Kur u ktheva në shtëpi, e hapa kutinë me shumë kujdes dhe pashë se ishin fotografi origjinale të bëra nga Lamerci gjatë Luftës së Parë Botërore dhe më herët. Për këtë koleksion kisha dëgjuar një herë para shumë viteve, por me sa di unë, askush nuk e kishte parë gjatë dyzet viteve.

Në një anë të kutisë kishte dhjetë diapozitivë të fshatrave arbëreshe nga viti 1913. Dihet se atë vit, mu para fillimit të Luftës së Madhe, Lamerci qëndroi në Italinë e Jugut për studime gjuhësore, kryesisht në Molize dhe në Abrucet. Fotografitë tregojnë fshatarë arbëreshë - burra, gra dhe fëmijë - në rrugë të fshatrave dhe para kishave dhe shtëpive të tyre. Disa persona janë veshur me veshje të kohës, por ka edhe disa poza të bukura më veshje tradicionale arbëreshe.

Pjesa dërrmuese e diapozitivave janë fotografi origjinale që Lamerci i ka bërë gjatë udhëtimit të tij në Shqipëri në verë të vitit 1916, kryesisht në Mirditë. Janë fotografi të pejsazheve të Mirditës dhe të Shqipërisë së Veriut, të mirditorëve, dhe të fshatrave dhe ndërtesave të tyre në mes të Luftës së Parë Botërore. Ka edhe një fotografi të bukur të Tiranës.

Fatmirësisht, për identifikimin e fotografive të koleksionit, ekziston një raport me shkrim

të Lambercit për udhëtimin e tij në Mirditë në atë vit. Ky shkrim, me titullin "Raport mbi studimet e mia gjuhësore në Shqipëri nga mesi i majit deri në fund të gushtit 1916" u botua gjermanisht në gazetën e Akademisë Perandorake të Shkencave në Vjenë, po në vitin 1916. Një pjesë të këtij raporti po e japim këtu të përkthyer për herë të parë në gjuhën shqipe. Është fjala për pjesën që lidhet drejtpërsëdrejti me udhëtimin e Lambercit në Mirditë, duke përfshirë këtu materialin gjuhësor.

3. Raporti i Lambercit për udhëtimin e tij në Mirditë, 1916

"Në pranverë të vitit 1916, Komisioni për Ballkanin i Akademisë Perandorake të Shkencave në Vjenë më dha detyrën që të merrja pjesë në një ekspeditë ballkanike të organizuar nga Akademia Perandorake e Shkencave në bashkëpunim me Ministrinë Perandorake të Arsimit dhe të Pedagogjisë dhe me Zyrën e Thesarit Perandorak me qëllim kryerjen e hulumtimeve gjuhësore dhe folklorike në Shqipëri.

U nisa nga Vjena më 19 maj [1916] bashkë me historianin e artit dhe epigrafistin e ekspeditës. Pas një qëndrimi të shkurtër në Sarajevë, i cili u shfrytëzua për kërkime në muzeumin krahinor, u nisëm për në Kotorr dhe pastaj u ngjitëm në Lovçen, për në Cetinje dhe Podgoricë. Këtu u ndava nga bashkëudhëtarët e mi dhe u nisa për në fisin Gruda. Ky fis shqiptar, i cili gjeografikisht është më i largëti, banon në malet në lindje të Podgoricës në luginën e Cemit, në fshatrat Dinoshë, Pikalë, Prift, Lofkë, Bozhaj dhe Selishtë. Baroni Nopça kishte udhëtuar në këtë krahinë në verë të vitit 1907 për të shkuar në Shalë dhe Kelmend. Më 28 maj arrita në Prift, një vendbanim midis Pikalës dhe Lofkës ku banon famullitari i Grudës. Nuk është një fshat i vërtetë, por ka një qelë të re të ndërtuar me fondet e monarkisë sonë, dhe një kishë, e cila ndodhet disa minuta prej saj. Emri i vendbanimit Prifti, si shumë toponime shqiptare, vjen nga emri ose titulli i banorit të parë. Për shembull, toponimi Domgjoni i cili ekziston në disa krahina të Shqipërisë së Veriut, do të thotë vendi ku ka banuar një famullitar me emrin Gjon, rreth të cilit u krijua një fshat. Toponimet e shumta që mbarojnë me *-aj* janë emra fisesh njësoj si toponimet tona gjermanisht me *-ing*, *-ingen*, *-ungen*. Famullitari i tanishëm i Grudës është françeskani mjaft mirëdashës, Bonaventura Gjeçaj, shqiptar, i cili quhet nga besimtarët e famullisë, Pater Bona, një shembull i mirë i antipatisë që kanë shqiptarët për emra të gjatë. Ai dhe Toger Çuninka [Czuninka], i cili administronte Grudën asokohe, më pritën përzemërsisht. Si pasojë qeshë në gjendje të kryeja hulumtimet e mia në mes të Grudës pa vështirësi sepse banorët e fshatrave përreth mbledheshin në Prift për shërbesa fetare, për të marrë pjesën e bereqetit prej qeverisë, dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore para gjykatësit të caktuar nga komandanti. Bisedoja me ta për të dëgjuar dialektin e tyre dhe, pasi e tejkaluan mosbesimin fillestar ndaj meje dhe u bindën se nuk kisha ardhur në luginën e tyre për të ndërtuar ndonjë fabrikë, ata më kënduan këngë me lahutë, të cilat i shënova me shkrim...

Pas disa ditëve atje, isha në gjendje të kuptoja deri diku dialektin e fisit të njerëzishëm Gruda. Do të kisha dashur të qëndroja më gjatë në luginën e bukur të Cemit, por doja të shkoja në Shkodër, qendrën shpirtërore të Shqipërisë së Veriut. Kështu mora rrugën për në Podgoricë dhe, duke qenë se bashkëudhëtarët e mi u shpërndanë nëpër Malin e Zi, secili i zënë me fushën e vetë, unë vazhdoja rrugën time për në Shkodër vetëm...

Kur pjesëmarrësit e tjerë të ekspeditës arritën në Shkodër, udhëtova me ata për në jug. Shkuam në Lezhë, ku bëra një ekskursion në Velë me Doktor Kidriqin [Kidrić]. Nga Lezha,

udhëtova me Doktor Bushbekun [Buschbeck] dhe një zotëri gjerman nëpër Fushën e Molungut për në manastirin e vjetër të Rubikut, tani i banuar nga françeskanët, historia e të cilit u hartua nga Millan fon Shufflaj [Milan von Šufflay] në vëllimin e tij tepër informativ *Illyrisch-albanische Forschungen* [Kërkime iliro-shqiptare], botuar kohët e fundit nga Ludvik fon Talloçi [Ludwig von Thallóczy]. Në Rubik kaluam ditën e Rrëshajës së Madhe. Nga manastiri mikpritës dhe hijerëndë, i vendosur mbi një mal prej të cilit shihej larg, zbritëm në luginën e lumit Fan deri në pikën ku lumi derdhet në Mat dhe, pasi kaluam Matin, arritëm në Milot. Gjatë kësaj pjese të udhëtimit, vura re se dialekti i Mirditës flitet gjithashtu në Malësinë e Lezhës dhe më tej nga Lezha deri në Adriatik. Nga Miloti vazhduam rrugën përmes Mamurrasit për në bazën e vjetër të Skënderbeut, në vendbanimin e bukur të Krujës me burimet e saj natyrore. Dialekti i Krujës nuk përputhet krejtësisht me të folurin e Durrësit dhe të Elbasanit, të përshkruar nga Vajgandi [Weigand], dhe duhet të studiohet dhe të shënohet më vete. Fatkeqësisht kësaj radhe nuk kisha kohë për këtë. Nga Kruja kalëruam përmes fushave pjellore të mbuluara me ullinj për në Tiranë, qyteti i Toptanëve i cili ka një vendndodhje të bukur. Ky qytet, me shtëpitë e tij madhështore dhe mikpritëse myslimane dhe kopshtet e bukura të fshehura në mënyrë idilike prapa mureve të verdha e të larta, që gjithsesi nuk binin në sy, na la mbresa të thella ...

Në Tiranë u ndava nga bashkëudhëtarët e mi, që të mos humbja kohë për detyrën time kryesore, dhe u ktheva në Shkodër nëpërmjet Durrësit dhe Lezhës, ku kësaj radhe vizitova Shëngjinin.

Në Shkodër ku qëndrova tri javë, vazhdova studimin e dialektit të Mirditës me Marka Gjokën dhe mirditorë të tjerë. Gjithashtu studiova këngë shqiptare për fëmijë me ndihmën e Patër Vinçenc Prennushit. Disa here shkova edhe në orë mësimi në shkolla të cilat punojnë sipas programeve austriake, edhe shkolla françeskane edhe shkolla publike. Djemtë, shumica e të cilëve ishin të shkathët dhe të talentuar, njohin mirë matematikën, gjeometrinë dhe gramatikën e shqipes. Françeskanët dhe shkolla publike japin edhe mësim të gjermanishtes me mjaft sukses, kështu që shumë të rinj mund të shërbejnë si përkthyes për trupat tona.

Në Shkodër shënova trembëdhjetë përralla drejtpërsëdrejti nga goja e tregimtarëve të zhdërvjellët. Nuk pata mundësi të shënoja më shumë sepse nuk kisha kohë të mjaftueshme për të zhvilluar biseda private me vendësit për t'u njohur me ata personalisht, gjë me rëndësi të veçantë në këtë fushë.

Ndërkohë, pjesëmarrësit e tjerë në ekspeditë ishin kthyer në Shkodër dhe vendosa të koordinoja planin tim për të shkuar në Mirditë me synimin e tyre për të udhëtuar në Gjakovë nëpërmjet Shqipërinë e Veriut, duke shpresuar kështu të arrija në Mirditë pas ndryshimit të rrugëtimit përmes Shqipërisë së Veriut. U nisëm nga Shkodra në fillim të korrikut dhe kaluam luginën e Kirit përmes Drishtit dhe Prekalit për në krahinën e Shoshit. Mark Lulashi nga Shoshi na shërbeu si udhërrëfyes dhe doli se ishte njohës i mirë i dialektit të Shoshit. Ky dialekt karakterizohet nga shqiptimi i *q* si *c* dhe i *gj* si *x*. Shënova gjithashtu disa këngë në dialektin e Shoshit. Nga Qafa e Gurakuqit, rruga na çoi përmes Shoshit poshtë në luginën e Lumit të Shalës, prej ku, duke lënë Abatin majtas, u ngjitëm për në Qafën e Agrit, e cila është kufiri midis Shalës dhe Merturit. Prej këndeje, u ngjitëm përmbi Paç për në Kotec dhe arritëm në luginën e Drinit para Kotecit. Udhëtimi na kishte ofruar pamje të mrekullueshme që nga Drishti e më tej, me male të larta e hijerëndë, me pamje të paqme të luginës në Shosh dhe pejsazhe të errëta të Shalës, por pasi hymë në luginën e Drinit, i cili gjarpëron prej këtu nëpërmjet maleve të Merturit, u mahnitëm nga pejsazhet vërtet të mrekullueshme. Nga Koteci në Drin u ngjitëm për në Rajë,

vendbanimi i fundit në Mertur. Kjo famulli, ku Patër Gjoni banon në vetmi, ndodhet aty ku Valbona derdhet në Drin. Më lart në luginën e Valbonës banon fisi mysliman Krasniqi, i cili nuk e meriton aspak namin e keq që ka si popull armiqësor dhe i egër. Në Gegëhysen u njoha me disa pleq krasniqas dhe vura re se janë njerëz të mençur që dinë të shijojnë një barcaletë të mirë dhe prapëseprapë janë myslimanë me mjaft dinjitet. Dialekti i tyre i përket grupit të Gjakovës. U ndava nga tre bashkëudhëtarët e mi në luginën e Valbonës, të cilët vazhduan në drejtim verilindor, kurse unë u nisa në drejtimin jugor, duke u kthyer në Rajë në hyrjen e luginës. Aty takova Beqir Noun dhe Kolë Markun të cilët u treguan të gatshëm të më informonin për dialektin e tyre në kufirin me Merturin ku, në një qetësi malore të përsosur, Valbona e ëmbël, e mbushur me peshq, derdhet në Drin, dhe fiset Krasniqi, Gashi dhe Thaqi puqen me Merturin...

Kalova Valbonën poshtë Rajës dhe pastaj kalova Drinin me një pirogë të dyfishtë jashtëzakonisht primitive. Tash ndodhesha në tokën e Fierzës, në zonën e fisit Thaqi, duke ndjekur për një farë kohe të njëjtën rrugë që kishte bërë Karl Shtajnmeçi [Karl Steinmetz] në gusht të vitit 1903, të cilën ai e përshkroi në librin e tij *Eine Reise durch die Hochländergaue Oberalbaniens* [Një Udhëtim për në Lartësitë e Shqipërisë së Epërme], vëllimi i parë i botuar nga Paç-i [Patsch] në serinë e tij *Schriften zur Kunde der Balkanhalbinsel* [Shkrime për Njohjen e Gadishullit Ballkanik]. Mirëpo ai udhëtoi në drejtimin e kundërt, nga jugu në veri, kurse unë udhëtova në drejtim të jugut nga Fierza përmes pyllit të virgjër dhe të bukur me lisa të gjatë deri në luginën e bukur të Iballës, e cila rrethohet nga malet nënalpine. Pronari i pirogës i cili më çoi nëpër Drin ishte udhërrëfyes dhe burim i mirë informues për dialektin e Thaqit i cili, po ashtu si dialekti i Rajës, është midis Gjakovës dhe Mirditës. Në Iballë, u largova prej rrugës së ndjekur nga Shtajnmeçi, i cili kishte ardhur në Iballë nga Kryeziu, dhe u nisa në një shteg në drejtim të perëndimit duke kaluar Qafën e Çomorisë. Prej këndeje, shtegu zbrit në Lumin e Sapaçit në Berishë dhe pastaj ngjitet me një të përpjetë të fortë në shpatet e Krrabës me pyje të zeza për të kapur Qafën e Tmugut. Prej andej, shtegu zbrit përmes lisnajeve në luginë pjellore të Qelëzës dhe ngjitet në një nivel prej 820 m. mbi nivelin e detit dhe arrin në rrafshin e Pukës. Gjatë rrugës rreth e rrotull ka pamje të bukura nga ana e veriut. Janë tetë vargmale njëri pas tjetrit, secili me ngjyrën e vetë, nga kodrat e veshura me gjelbërim deri në masivët shkëmborë dhe të hirtë të mbuluar me borë. Prej këndeje shihet gjithë Shqipëria e Veriut, deri në Bjeshkët e Shqipërisë së Veriut dhe Malit Shkëlzen. Lart në pllajë kuptohet se romakët kishin patur sy të mirë, jo vetëm në Carnuntum të Austrisë por edhe këtu në Epicaria [Pukë], duke zgjedhur vendet më të mira për ngulimet e tyre, prej të cilave kontrollonin tërë rajonin. Fon Hani [von Hahn] dhe Baroni Nopça që të dy kishin pranuar se kodra mbi të cilën ndodhet xhamia e tanishme është pa dyshim vendi i fortifikimeve romake. Prova të mjaftueshme janë forma drejtkëndëshe e kodrës, mbetjet e dukshme të mureve antike të ngritura me gurë të gdhendur, disa prej të cilëve janë në muret e armatores, dhe së fundi, minareja e xhamisë e ndërtuar gati tërësisht me gurë romakë. Nga Puka, shkova fillimisht në drejtim të lindjes për në Bicaj në luginën e Fanit të Madh dhe pastaj për një ditë të tërë vazhdova nëpër shtigje të rrezikshme lart mbi luginën e Fanit në drejtim të jugut për në Kalivare. Nga Bicaj isha në Mirditë dhe ndodhesha përsëri në rrugën e përshkuar nga Shtajnmeçi. Vendbanimet që kalova në Mirditë, në bajrakun e Spaçit, ishin Shmihija, Shkoza dhe Gojani. Në Kalivare e lashë luginën e Fanit të Madh dhe u ngjita nga lugina e gjelbërt e Lumit të Kalivares përmes Mesulit dhe kullotave malore të Mushtës të Qafa e Lugjut (1465 m.) në shpatin jugor të majës së Munellës. E lashë majën majtas, në të cilën Shtajnmeçi u ngjiti për herë të parë në vitin 1903 dhe të cilën burrat e Mirditës e përdorën si pikënisje për betejat e tyre me Esadin në vitin e kaluar, dhe u ngjita, i udhëhequr nga Mark Deda i Domgjonit, për orë të tërë përmes ahishteve të bukura ku gjatë rrugës pashë llogore dhe pengesa nga luftimet e fundit. Arritëm në kullotat malore të Domgjonit që ashtu si ato të Mushtës, më dhanë një ndjesi të qartë

të bjeshkëve tipike shqiptare, dhe pastaj zbrita në luginën e Fanit të Vogël në drejtim të Domgjonit. Aty u ndava nga Mark Deda të cilin e kisha shfrytëzuar shumë për hulumtimet e mia gjuhësore. Duke zbritur luginën e Fanit të Vogël, mora shtegun pas famullisë së Fanit dhe kalova natën në një vend të fshehtë në shkëmbinjtë i cili përdoret si vendtakimi i krerëve të bajrakut. Të nesërmen arrita në Orosh, kryeqendrën e Mirditës.

Vendbanimi i abatit të Mirditës i cili ka një pozicion të mirë, është përshkruar tashmë nga disa udhëtarë, veçanërisht nga A. Degrand në *Souvenirs de la Haute-Albanie* [Kujtime nga Shqipëria e Epërme] (1903) dhe K. Shtajnmec në librin e lartpërmendur. Me vendndodhje mbi një brezare në bregun e majtë të Fanit, në mes të rrugës kur ngjitesh prej luginës, Oroshi, me kishën e shkëlqyer që shihet nga larg nga ana jugore, dhe me abacinë e madhe, të kujton Maria-Taferl në vendin tonë. Përballë në një rrëpirë, në formë gjuhe, të Malit të Shejtit ndodhet fshati Orosh. Abati banon tani në Shkodër dhe abacia është bërë selia e komandës ushtarake. Aty bujta disa ditë si mysafir. Qëndrimin tim e shfrytëzova për t'u ngjitur disa herë në fshatin Orosh për të vizituar mirditorët në kullat e tyre dhe për të mësuar më shumë për dialektin e tyre përmes hartimit të fjalëve dhe të bisedave. Vura re me kënaqësi se miqtë e mi mirditorë në Shkodër më kishin mësuar gjuhën e pastër të Mirditës.

Me gëzim shfrytëzova rastin për të shkuar në rajonin fqinj të Lurës kur një patrullë e xhandarmërisë u nis nga Oroshi dhe komandanti i saj më ftoi t'a shoqëroja. Kjo është krahina e një prej fisese më famëkëqij shqiptarë i njohur për egërsinë dhe armiqësinë ndaj të huajve. Unë kisha mësuar për të nga përshkrimet e K. Shtajnmecit në librin e tij *Von der Adria zum schwarzen Drin* [Nga Adriatiku në Drinin e Zi]. Pas një dite marshimi nga Oroshi arritëm në Lurë. Shtegu shkon majtas nga Mali i Shejtit përmes hapësirës së gjerë të pyllëzuar të Fushës së Shejtit. Në mesditë pushuam nga ana lindore e saj. Aty pamë disa kasolle prej balte dhe shumë kuti konservash ushqimore të zbrazëta me shkronja çirilike, të mbetura prej fushimit serb nga ditët e arratisjes nëpërmjet Shqipërisë të ushtrisë së mundur serbe. Prej këndej shtegu zbrit në luginën e Mallës dhe ngjitet prapë majtas përmes një gryke të pyllëzuar për në Lurë të Epërme, e cila ka një vendndodhje të mrekullueshme në një luginë në një lartësi prej 1100 m. Ky vend më kujtoi fshatrat tona të larta të Tirolit: Gurgl dhe Vent. Në atë kohë Batalioni 19 Perandorak i Pushkatarëve ndodhej rastësisht në Lurën e Epërme ku kishte ndërmarrë një ekspeditë. Komandanti i tij, Nënkoloneli Broser, më priti përzemësisht dhe, duke qenë se i duhej të shkonte nga Lura për në Kthellë dhe Selitë si gjykatës, më pyeti nëse do të kisha dëshirë ta shoqëroja dhe të vija njohuritë e mia të gjuhës vendore në dispozicion të ekspeditës. Unë e pranova propozimin e tij me kënaqësi jo vetëm sepse doja ta ndihmoja, por edhe sepse udhëtimi më dha një mundësi të mirëpritur për t'u njohur me fisin dhe me gjuhën e Kthellës. Pas mbarimit të gjyqit në Kthellë, udhëtova me Batalionin 19 të Pushkatarëve përmes Oroshit dhe Kthellës së Epërme për në Selitë ku në Qafën e Kishës ngritëm fushimin midis kishës dhe famullisë në mes të këtij fisi jopaqësor. Çfarë përjetova gjatë dhjetë ditëve të qëndrimit me Batalionin 19 të Pushkatarëve, ku bashkëpunova ngushtë me oficerët e trupave të cilët ishin mjaft të afrueshëm, në një nga krahinat më të ashpra të Shqipërisë, i përket më shumë një kapitulli të historisë politike të Shqipërisë në këtë kohë të trazuar se sa një raport i shkencor për një institucion akademik. Mjafton të theksohet se si myslimanët e Lurës po ashtu edhe katolikët e Kthellës, që në asnjë mënyrë nuk ishin më të mirë, duhej të mësonin se “kohët e vjetra të arta” në Shqipëri kishin përfunduar dhe se qytetërimi evropian, i përfaqësuar nga ushtria austro-hungareze, tash po trokiste në derën e Shqipërisë, e cila deri tani kishte mbetur e mbyllur ndaj çdo përparimi kulturor dhe etik.

Pasi kreva detyrën time si “përkthyes gjyqi” dhe pasi mësova diçka për dialektin e këtyre fiseve, i cili është mjaft i ngjashëm me dialektin e Mirditës, u ndava prej zotërinjve të batalionit dhe u ktheva në Shkodër përmes Oroshit, Blinishtit, Ungrejt, Vigut dhe Vaut të Dejës. Dhe pas një qëndrimi të shkurtër, u nisa për në shtëpi.”

[Nxjerrë nga Maksimilian Lamberg: Raport mbi studimet e mia gjuhësore në Shqipëri nga mesi i majit deri në fund të gushtit 1916 [Bericht über meine linguistische Studien in Albanien vom Mitte Mai bis Ende August 1916]. në: Anzeiger der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Phil.-hist. Kl. Vjenë, 53 (1916), Nr. XX, f. 122-146. Përkthyer nga gjermanishtja nga Robert Elsie.]

[Botuar në: *Albanica Ekskluzive, revistë mujore për dije e kulturë*, Prishtinë, 61, tetor 2006, f. 96-101 / Published in: *Albanica Ekskluzive, revistë mujore për dije e kulturë*, Prishtina, 61, October 2006, p. 96-101]